

2 Vapa dhe puna në kantieri ndërtimi
Shëndeti para presionit të afateve

3 Referendumi kundër uljes së pensioneve
Gratë janë më së shumti të prekuara

4 Kursi 2 ditorë i radhës në gjuhën shqipe
Pensioni i pleqërisë në Zvicër

Nr. 5 | Shtator 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Parlamenti me qëndrim të ashpërsuar tek ligji për natyralizim

Tani nevojitet debat në shoqëri



Pamje nga aksioni i "Nismës për demokraci" dhe iniciatorëve e mbështetësve të saj para pallatit federal të Zvicrës në Bernë

Janë paraqitur shumë parashtrës për rishqyrtimin e ligjit për shtetësi. Të gjitha këto u refuzuan nga shumica e djathtë në parlament. Për ish-in vetëm Partia Socialdemokrate (PS), të Gjellbrit dhe Liberalët e Gjellbër. Parlamenti nacional nuk dëshiron të ulë hendeqet. Kjo do të thotë se nisma e natyralizimit e shoqatës «Vierviertel» ka edhe rëndësi të madhe. Duhet 100 mijë nënshkrime dhe më pas populli mund ta votojë.

Emine Sariaslan

Parashtrës e paraqitura kërkonin lehtësime me rastin e natyralizimit: të huajt duhet të vazhdojnë të votojnë në Zvicër për dhjetë vjet, para se të mund të aplikojnë për një pasaportë zvicerane. Mocioni i Liberalëve të Gjellbër, i cili kërkonte uljen e kohëzgjatjes së qëndrimit në shtatë vjet, u hodh poshtë me 107 vota kundër 83 për dhe një abstenimi. Për më tepër, lartësia e kohëzgjatjes minimale me vite e vendbanimit në komunë duhet të reduktohet në një deri në tre vjet. Kjo nismë dështoi me 102 vota kundër 89 për dhe 1 abstenimi. Aktualisht, kantonet janë të detyruara të parashohin një qëndrim minimal prej të paktën dy dhe më së shumti pesë vjet. Përveç kësaj, atyre që në një mbledhjet komunale kanë të drejtë të votojnë u lejohet edhe më tej që të vendosin për një kërkesë natyralizimi. Katja Christ (GLP/BS) donte që në çdo rast vendimin për natyralizim ta transferonte tek një parlament, një organ ekzekutiv, një komision autoritetesh ose një organ të ngjashëm. Parlamenti nacional e hodhi poshtë këtë me 104 vota kundër 87 për dhe 1 abstenimi.

S'ka përjashtime as për fëmijë

Së fundi, pengesat e natyralizimit për fëmijët e të huajve nuk do të ulen, pasi dhoma e madhe (e kantoneve) vendosi me 105 vota pro, 85 kundër dhe 1

abstenim. Edhe nxënësit që vite të gjata kanë ndjekur shkollimin këtu duhet t'i nënshtrohen testit të natyralizimit.

Më 2018, ashpërsimi i parakushteve

Në vitin 2018 u rishikua Ligji për shtetësi. Me këtë rast nga njëra anë, kohëzgjatja minimale e qëndrimit u reduktua nga dymbëdhjetë në dhjetë vjet. Ndërsa, nga ana tjetër, parakushtet tjera u ashpërsuan. Personat e pranuar përkohësisht nuk mund të aplikojnë më për shtetësi. Përveç kësaj, vetëm dikush që flet një nga gjuhët zyrtare me gojë në nivelin B1 dhe me shkrim në nivelin A2, d.m.th. të është në gjendje të kuptohet gjuhësisht pothuajse në të gjitha situatat e përditshme, mund të vjen në pyetje për natyralizim. Edhe ata që marrin ndihmë sociale nuk mund të aplikojnë më. Kantonet gjithashtu mund të formulojnë kërkesa shtesë për integritet dhe të ashpërsojnë më tej kërkesat federale. Në kantonet Aargau dhe Bernë, mund të aplikohet për natyralizim vetëm nëse nuk është marrë asnjë përfitim nga sigurimi social për të paktën dhjetë vjet. Dhe në kantonin e Thurgaut, aplikantët duhet të jenë në gjendje të flasin gjermanisht në nivelin B2 në vend të nivelit B1 siç kërkohet nga ligji federal zviceran. Ata jo vetëm që duhet të jenë në gjendje të mirëkuptohen në gjuhën

e përditshme, por edhe të jenë në gjendje të shprehin mendimin e tyre spontanisht.

Ligji aktual i shtetësisë është jodemokratik, duke mohuar kështu të drejtat politike për një të katërtën e popullsisë në Zvicër. Një studim i vitit 2016 nga Universiteti i Lucernit në këtë çështje e renditi Zvicrën në vendin e fundit nga më shumë se 20 vende evropiane. Vetëm Qiproja doli më keq.

Nismë për demokraci

Nisma «Për një të drejtë moderne të shtetësisë (nismë për demokraci)» dëshiron që ta ndryshojë situatën, për të lehtësuar qasjen në pasaportën zvicerane duke përdorur vetëm kritere objektivisht të matshme vendimmarrëse. Mjaftojnë që kërkuesi të ketë pesë vjet qëndrim të ligjshëm dhe njohuri themelore gjuhësore si dhe nuk duhet të ketë kryer një vepër të rëndë penale.

Komiteti nismëtar për të grumbulluar 100 000 firmat e nevojshme mbledh nënshkrime çdo ditë gjithandej në rrugë e në manifestime. Kështu krijojmë mundësinë që të korrigjojmë procedurat e rrepta, kufizuese të natyralizimit.

Editorial



20 vite pensionim të parakohshëm në ndërtimtarë – FAR, falë luftës së ashpër!

Ata punojnë përditë jashtë. Në vapë, shi e acar dhe erë. Punëtorët e ndërtimtarisë kryejnë një punë tejet të mundimshme. Shumica ishin punëtorë sezonierë, ndërsa sot janë gati se 80% migrantë, të cilët nuk kursejnë shëndetin e tyre për ndërtimin e vendit. Para më se gati 20 viteve ata thanë: 40 vite mjaftojnë dhe luftonin për pensionim me 60 vjet. Suksesshëm. Qe 20 vite – pikërisht që nga qershori 2003 – punëtorët e ndërtimtarisë mund të shkojnë në pension me 60 vjet. Kjo është e garantuar edhe me Kontratë Kolektive të Punës.

Albino da Silva i takon këtyre punëtorëve të ndërtimtarisë, që tërë jetën e tyre kanë punuar në ndërtimtarë. Nga moshja 55 vjeç punë ishte bërë më vështirë, thoshte ai në bisedë (faqe 3). «Njeriu donë të jetë i fortë, mirëpo trupi nuk mund të përballojë më shumë». Lufta e punëtorëve të ndërtimtarisë për pensionim me 60 ishte e vështirë, mirëpo e rëndësishme. Bliokimi i tunelit Baregg ishte kulmi i luftës, nga e cila sot përfitojnë mbi 26 000 punëtorë ndërtimtarë.

Si sekretar sindikate ne njohim këto natyra luftarake dhe i gëzohemi suksesit të tyre si dhe 5 viteve të fituara të jetës cilësore. Shumë punëtorë ndërtimtarë sot festojnë ditëlindjen e 60 të tyre dhe pensionimin. Kështu edhe Xhemshir Zenuni. Festimi ishte organizuar fshehurazi nga fëmijët e tij. Miqtë, kolegët, familjarët festuan bashkë. Pasi që ai është shumë aktiv në Facebook, unë munda ta shihja se si ai e shijonte kohën me familje, udhëtimet me miq dhe përsëri fotografi me nipërit e mbesat e tij. Ai do të pajtohej me kolegun da Silva, ku ai thotë: «Të kem kohë për nipërit e mbesat e mia dhe t'i shikoj ata të rriten është gjëja më e mirë që mund të më ndodhte».

Hilmi Gashi

News

Çdo i katërti vend pune dëmton shëndetin

Gati se një e katërta e punonjësve në Zvicër i nënshtrohen një rreziku për sigurinë ose shëndetin në punë. Kur bëhet fjalë për shpejtësinë e punës dhe presionin e afateve, Zvicra është kampione e Evropës. Në degë të ndryshme, punonjësit e të cilave i përfaqëson Unia, përveç ngarkesave të larta fizike, u shtohen edhe orë të vështira pune. Kjo situatë është veçanërisht në ndërtim, gastronomi, përkujdes dhe logjistikë. Është koha e fundit që duhet bërë përparim me parandalimin në fushën e ngarkesave ergonomike. Për sa i përket orarit të punës, nga pikëpamja shëndetësore, janë gjithashtu të domosdoshme ditët dhe javët më të shkurtra të punës. Punëdhënësit janë përgjegjës për të siguruar që vendet e punës të jenë të sigurta dhe jo të dëmshme për shëndetin. Një element qendror është bashkëndikimi i punonjësve, siç përcaktohet në Aktin e Pjesëmarrjes për çështjet e mbrojtjes shëndetësore. Megjithatë, studimi tregon se një e treta e punonjësve nuk kanë mundësi të bashkë ndikojnë. Unia u bën thirrje ndërmarrjeve që ato të këshillohen vazhdimisht me punonjësit për çështjet e mbrojtjes shëndetësore dhe të zbatojnë preokupimet e shqetësimet e tyre.

Ekipi punonjës i Archroma fiton kompensim të denjë largim

Në mars firma Archroma bleu divizionin e tekstilit të Huntsman. Archroma mbështetet nga firma amerikane e investimeve SK Capital. Në fillim të qershorit, Archroma njoftoi se në pranverën e 2024 do të mbyllte vendndodhjen e Bazelit dhe do të zhvendosej në Azi. Janë të prekur rreth 45 kolegë që punojnë në Bazel në kërkimin dhe zhvillimin e ngjyrave të reja. Shumica prej tyre kanë qenë në ndërmarrje për më shumë se dhjetë vjet, një numër i madh i tyre edhe për më shumë se 30 vjet. Vendndodhja është një qendër globale e kompetencës që mbështet vende të ndryshme prodhimi dhe klientë në mbarë botën. Koncerni refuzoi të përpilonte një plan social dhe donte të mashtronte punonjësit afatgjatë me pagesa kompensimi largimit vetëm nga një deri në tre muaj. Rreth 45 kolegë të prekur, me aksione të ndryshme proteste, luftuan me guxim, vendosmëri dhe solidaritet kundër vendimit të kompanisë për mbylljen e vendndodhjes. Me sukses: Koncerni tani ka premtuar kompensime shumë më të larta për largim nga puna si dhe masa sociale.

Skandali i dumpingut të pagave Goger: Tani duhet të veprojnë politikanët!

Kurt Goger nga Goger-Swiss AG është përgjegjës për skandalin më të madh zviceran të dumpingut të pagave. Në të njëjtën kohë, Goger i mashtroi punonjësit masivisht, dyshohet deri në 10 milionë franga. Unia, e cila e nisi çështjen në vitin 2015, së fundi e zbardhi rastin dhe njoftoi të gjithë përgjegjës dhe autoritetet. Por sipërmarrësit dhe autoritetet përgjegjëse në fakt e kanë anashkaluar rastin. Ndërkohë, Goger tanimë është fshehur nga autoritetet zvicerane në Austri. Rasti Goger tregon se si sipërmarrësit e ndërtimit, ndërmarrjet të përgjithshme dhe kompani të caktuara shfrytëzojnë paturpësisht boshllëqet në sistemin aktual. Fatura paguhet nga punonjësit dhe të gjitha ndërmarrjet që respektojnë dispozitat minimale në fuqi. Zvicra nuk ka nevojë për më pak, porse për më shumë mbrojtje të pagave dhe, së fundi, por jo më pak e rëndësishme, është e nevojshme rritja e resurseve dhe zbatimi nga ana e shtetit kur hetohet kriminaliteti ekonomik me përfshirjen e duarve të njeriut.

Deri në 17 përqind të kontrolleve zbulojnë dumpingun e pagave

Siç njoftoi së fundmi Sekretariati Shtetëror Ekonomik i Zvicrës (Seco), në vitin 2022, organet zbatuese, si pjesë e masave shoqëruese (FlaM), kontrolluan pagat dhe kushtet e punës së 165.845 personave në 37.134 ndërmarrje. Shkalla e shkeljeve në sektorët me kontrata kolektive përgjithësisht detyruese ra nga 21% një vit më parë në 17%. Komisionet trepalëshe kantonale (TPK), nga ana tjetër, gjetën një rritje në uljen e pagave nga 13 në 16% në mesin e punëtorëve të dërguar në sektorë pa një pagë minimale të detyrueshme. Nga kontrollat e punës në të zezë (të padeklaruar) kanë rezultuar edhe 13147 dyshime. Në 3044 raste, autoritetet speciale raportuan sanksione ose masa të tjera tek organet e kontrollit kantonale. (saw/sda)

Vala e të nxehtit në kantieret e ndërtimit

Nënshkruaje peticioni: Shëndeti para presionit të afateve!

Përsëri është shumë vapë dhe temperaturat ngrihen mbi 30 °C. Punëtorët kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre. Së bashku me Unia, ata kanë nisur një peticion për ndërmarrjet, sipërmarrësit e ndërtimit dhe politikanët, ku shpalosin kërkesat e tyre.

Marie Saulnier Bloch

Realiteti venë në pah se po ndërtohen gjithnjë e më shpejt dhe me gjithnjë e më pak njerëz. Presioni i afateve sa vjen e po rritet, kështu që puna kryhet edhe në nxehtësi të jashtëzakonshme dhe shpesh nuk mund të respektohen masat paraprake të sigurisë. Rreziku i aksidenteve rritet: shëndeti i punëtorëve është në rrezik. Sipas Suva, rreziku i aksidenteve në kantieret e ndërtimit rritet me 7% në ditët me temperatura mbi 30°. Pothuajse 1000 punëtorë çdo vit sëmurën me kancer të lëkurës për shkaqe profesionale. Kësaj duhet shtuar edhe dehidratimet e shumta dhe përcëllimet nga dielli.

Nevojitet ndërmarrja e masave

Punëdhënësit nuk janë më të gatshëm të sakrifikojnë shëndetin dhe sigurinë e tyre për të përmbushur presionet në rritje të afateve. Nëse situata është e rrezikshme, puna duhet të ndërpritet. Nëse kjo nuk garantohet dhe kërkesat e punëtorëve nuk dëgjohen, Unia do të ndërhyjë në terren. Për të mbrojtur punëtorët e ndërtimit-risë kërkohen katër masa. Së pari, Kontrata Kombëtare në Ndërtimtari (KKP) duhet të merret seriozisht: Nëse shën-

deti është në rrezik, puna në mot të keq ose valë të nxehtë duhet të riorganizohet ose të ndalet. Së dyti, standardi SIA 118 duhet të respektohet rreptësisht! Nëse puna ndërpritet për shkak të motit të keq ose vapës, ndërmarrjet e ndërtimit duhet të lejohen përshtatjen e afateve. Nuk lejohet të shqiptohet asnjë ndëshkim kontraktual. Përveç kësaj, nuk mund të lejohen më që punëtorët të punojnë jashtë orarit përpara se të paguhet sigurimi i motit të keq, ndërsa edhe dy ditët e pritjes gjatë valëve të të nxehtit duhet të reduktohen. Së fundi, në ligj duhet të futen kritere të qarta për ndalimin e punës në mot të keq dhe vapë.

Një peticion që kjo të ndryshojë

Nënshkruaje këtë peticion dhe shpërndaje sa më gjerësisht të jetë e mundur. Kështu që ne në vjeshtë të mund të dorëzojmë shumë nënshkrime. Peticionin mund ta gjeni këtu: www.unia.ch/de/kampagnen/bau-schlechtwetter-und-hitze



Vapa dhe moti i keq në ndërtimtari rrezikon shëndetin



Bisedimet për Kontrata Kolektive të Punës

Pagat në gastronomi po rriten

Në industri është mënjano përkeqësimi i kohës së punës dhe KKP-ja është zgjat për pesë vite të tjera. Ngacmime seksuale, mobing, planifikim afatshkurtër pune, shefi gjithmonë pas shpine, gjithashtu edhe jashtë orarit të punës, heqja e pazave dhe e ditëve të pushimit, paga të ulëta, pabarazi pagash: Një anketë e sindikatës Unia me të punësuarit në gastronomi e hotelieri i qet një hije të keqe kushteve të punës në këtë sektor. Kjo gjendje nuk mund të vazhdojë më tej!

Hilmi Gashi

Gastronomia: Pagat minimale në gastronomi do të rriten edhe në vitin 2024. Unia bashkë me partnerët tjerë kontraktual ka arritur të negociojë dhe lidhë një Kontratë Kombëtare të Punës për Gastronomi (KKP) me kompensim të inflacionit dhe pagat minimale. Pos kësaj rriten pagat reale për 5 franga në muaj në secilën shkallë të pagave minimale.

Unia kërkon rritjen e pagave efektive nëpër ndërmarrje

Mjerisht, pagat efektive (pagat mbi pagën minimale) në degën e gastronomisë nuk janë zhvilluar mirë vitet e fundit. Kjo ka kontrbuar që shumë punëtorë të migrojnë në sektorë tjerë industrial ku pagat janë më të mira dhe orët e punës janë më pak të vështira. Unia kërkon që ndërmarrjet në degën e gastronomisë të paguajnë

këtë vit kompensimin e inflacionit mbi pagat efektive në të njëjtën masë si për pagat minimale në dy vitet e fundit, kjo domethënë të paktën 6 për qind. Në të njëjtën kohë me negociatat për pagat, palët kontraktuese ranë dakord të kërkojnë nga Qeveria Federale zgjatjen e deklaratës së vlefshmërisë së përgjithshme të Kontratës Kombëtare të Punës deri në fund të vitit 2024. Kështu, KKP do të vazhdojë të jetë e detyrueshme për të gjithë punonjësit në degën e gastronomisë dhe hotelierisë.

Industria e makinerive dhe metali: Kanë përfunduar negociatat për një Kontratë të re Kolektive të Punës për industrinë e makinerive, asaj elektrike dhe metalike (KKP për MEM). Delegationi ynë ishte në gjendje të shmangte një rritje të orarit të punës. Fatqësisht, nuk kishte asnjë marrëveshje për përmirësim që do ta kishin bërë industrinë më tërheqëse për punonjësit. Organizatat e punëmarrësve paraqitën me kohë një katalog të detajuar të kërkesave për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të kundërshtuar mungesën e punëtorëve të kualifikuar në industri. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së negociatave, shoqata e punëdhënësve ASM-Swissmem refuzoi të negociojë ndonjë përmirësim thelbësor për punonjësit. Edhe më keq se kaq, punëdhënësit donin të rrisnin orët javore të punës në 42 orë. Gjë që do të nënkuptonte një hap gjigant prapa në vitet 1980. Java 40-orëshe në industrinë MEM është në fuqi që në vitin 1988. Kjo, për punonjësit dhe organizatat e tyre nuk erdhi fare në shprehje për tu diskutuar. Përveç kësaj, ASM-Swissmem kërkoi një përkeqësim të të drejtave të konsultimit të përfaqësuesve të punonjësve në rast të shkurtimeve masive dhe rristurimeve. Duke pasur parasysh frontet e ngurtësuar, palët kontraktuese ranë dakord të rinovojnë KKP-në ekzistues të MEM-it për pesë vjet të tjera deri në qershor 2028. KKP për MEM përmban parametra kyç si përshtatja automatike e pagave minimale me inflacionin, javën 40-orëshe dhe të paktën pesë javë pushime, një pagë mujore të 13-të dhe të drejtat e bashkë-ndikimit në komisionin e personelit.



Kushtet më të mira pune në gastronomi e industri

Konferenca: Pjesëmarrje në vend të përjashtimit

Tejkalimi i pasigurisë dhe racizmit me një politikë migracioni largpamëse

Për disa dhjetëvjeçar, partitë e djathta populiste përcaktojnë tonin në diskutimet për migracionin. Ata kanë arritur që, opinioni vendor, migrantët në radhë të parë t'i perceptojë si problem dhe kërcënim për sigurinë dhe prosperitetin. Ky diskurs çnjerëzor përcakton edhe praktikën e parlamentit dhe të administratave, duke vendosur gjithnjë e më shumë për reduktim të të drejtave, të cilat vendime më pas zbatohen nëpër kantonet zvicerane.

Marek Wieruszewski

Kjo politikë, e cila refuzon njerëzit që kanë qenë të detyruar të ikin, i bën të pasigurt njerëzit me sfond migrimi, mohan pjesëmarrjen politike të njerëzve pa pasaportë zvicerane deri edhe dëbon ata që janë prekur nga varfëria, është e rrezikshme. Kjo krijon frikë, mosbesim dhe pasiguri – potencialisht për të gjithë njerëzit në shoqërinë tonë.

Ne, njerëzit solidarë, duam ta kundërshtojmë këtë politikë. Me konferencën tonë «Pjesëmarrja në vend të përjashtimit!» ne tregojmë se si duhet të duket për të gjithë një politikë migracioni solidarë, progresive, gjithëpërfshirëse dhe e ardhme si dhe po këto i kërkojmë edhe nga politika zyrtare. Përqendrimi i konferencës është në temat «Liria e lëvizjes në vend të kufijve», «Dinjiteti dhe të drejtat në vend të ilegalizimit», «Pjesëmarrja ekonomike dhe sociale» si dhe «Pjesëmarrja politike». Grupet, organizatat dhe lëvizjet sociale janë duke u rrjetëzuar në prag të konferencës, me qëllim që të prezantojnë angazhimin e tyre për një politikë më të mirë të migracionit dhe

duke i dhënë shtysë të re betejave tona me një katalog të përbashkët kërkesash për politikanët.

Të shtunën, më 23 shtator 2023, nga ora 12:00 – 17:00 në Generationenhaus Bahnhofplatz 2, Bern
Organizuar nga Solidarité sans frontières, VPOD/SSP, Unia dhe Solinette.ch
Lajmërimi për «Teilhabe statt Ausgrenzung!» në: sekretariat@sosf.ch



Referendumi kundër uljes së pensioneve BVG 21

Të paguash më shumë, për më pak pension

Është dorëzuar referendumi kundër reformës së shtyllës së dytë të pensioneve BVG 21: Mbi 140 000 njerëz kanë nënshkruar kundër uljes së pensioneve. Unia bashkë me një aleancë të gjerë i kundërshton përqesimet.

Marek Wieruszewski

Në të vërtetë pensionet, nga fondi pensional profesional (shtylla e dytë e sigurimeve shoqërore), do duhej rritur. Të paktën kështu ishte premtuar. Sidomos për gratë, të cilave tashmë iu është rritur mosha e pensionit. Por, rezultojtë se e tëra ishte një rritje e kontributeve dhe ulje e pensioneve. Edhe pse kontributet që zbriten nga paga janë rritur, pensioni i ardhshëm i (arkës së pensioneve profesionale) BVG do të reduktohet me 270 CHF.

Gratë janë më së shumti të prekura

Reforma do të kishte pasoja negative për njerëzit me të ardhura të ulëta ose ata që punojnë me kohë të pjesshme. Pra kryesisht për gratë. Pas 'AHV 21', ky propozim do të nënkuptonte një përqesim të mëtejshëm për gratë.

Teorikisht, ligji i ri pas aprovimit duhet do të hyjë në fuqi më 1 janar 2025. Për ta parandaluar, duhet një JO në referendum. Për reformën e BVG në fjalë, sipas të gjitha gjasave, do të votohet më datën 3 mars 2024.



Dorëzimi i mbi 140 000 nënshkrimeve të mbeldhuara nga Unia dhe aleatët e saj për të kundërshtuar përqesimet.

Intervista



«Të shoh nipërit e mbesat duke u rritur është gjëja më e mirë që mund të më ndodhte»

Para 20 viteve, në korrik 2003, hyri në fuqi pensioni i parakohshëm në ndërtimtarin (FAR). Punëtorët e ndërtimtarisë këtë e arritën me betejë dhe mobilizim disa vjeçar. Lufta ka dhënë rezultat: deri më tani, më shumë se 26800 punëtorë ndërtimtarie kanë përfutuar nga kjo mundësi. Një prej tyre është portugezi Albino Manuel da Silva, tashmë 62 vjeç. Albino është anëtar i Unia-s që 34 vjet. Ai nuk mungoi në asnjë demonstratë të punëtorëve të ndërtimtarisë. Ai asokohe mori pjesë në të gjitha protestat dhe fushatat për FAR-in, duke përfshirë edhe aksionin për bllokimin e tunelit Baregg më 4 nëntor 2002. Tani ai është i lumtur që edhe vetë ka dalë në pension të parakohshëm.

Albino Manuel da Silva, sa vite keni punuar në ndërtimtarin?

Gjithë jetën time të rritur. Fillova ndërtimtarinë në Portugali kur isha 15 vjeç. Unë kam qenë në Zvicër plotë 34 vjet, gjithmonë në industrinë e ndërtimit. 32 vite kam punuar për të njëjtin punëdhënës, kompaninë «Martí». Aty më kanë trajtuar gjithmonë mirë, kisha shefa të shkëlqyer dhe shumë kolegë të mirë.

Por a nuk ishte shumë e lodhshme të punoje në ndërtim kaq vite?

Jo. Më pëlqente puna, të punoja jashtë ishte mirë për mua. Dhe në ndërtim keni liri të caktuara, për shembull më ndryshe se në një fabrikë. Sigurisht që është punë shumë e vështirë. Por ne mund të bisedonim me kolegët tanë, të tregonim vica, ndërsa gjatë punës dhe gjatë pushimeve edhe të bënim shaka me njëri-tjetrin... Më pëlqente kjo atmosferë, liria që kishim për t'u shoqëruar.

Megjithatë, ju keni dalë në pension të parakohshëm në moshën 60...

Po ashtu është. E dini, që në moshën 55-vjeçare e kupton se nuk mund të bësh më sikur deri në këtë moshë. Njeriu dëshiron të jeni të fortë, por trupi nuk mundet më. Njeriu ka më shumë dhimbje, shëndeti vjen duke ra... Dhe në pesëmbëdhjetë vitet e fundit presioni në ndërtim është rritur ndjeshëm. Kemi më shumë afate për të përmbushur dhe ka më shumë punë për të bërë. Por ka më pak personel dhe duhet të punojmë më shpejt. Presioni është i madh, po ashtu edhe stresi. Gjë që është keq për shëndetin dhe rrit rrezikun e aksidenteve... Prandaj vendosa të tërhiqem në moshën 60-vjeçare. Në kompaninë time, ata donin që unë të qëndroja më gjatë, por unë më me dëshirë papapëlqeva të kisha kohë për veten dhe familjen time, përderisa jam ende i shëndetshëm.

Ju morët pjesë në bllokimin e tunelit Baregg, i cili ishte thelbësor në luftën për pensionin e parakohshëm: pas bllokadës, ishte e mundur të negociohej FAR. Si ishte të merrje pjesë në këtë aksion?

Ishte fantastike. U ndamë në dy grupe, njëri grup bllokonte hyrjen veriore, tjetri hyrjen jugore të tunelit. Ne punëtorët e ndërtimtarisë ishim të vendosur dhe të bashkuar, të gjithë ishim të motivuar për të marrë pjesë. As zemërimi i shoferëve de shefa dhe asgjë tjetër nuk na frikësojë dhe nuk na ndaloj. Atmosfera mes nesh na bënte të fortë, ndjenim fuqinë e unitetit.

Tani që je në pension, ke më shumë kohë të lirë. Çfarë bëni me të?

Për momentin jam me pushime në Itali dhe po shijoj plazhin. Do të kaloj edhe një kohë me nënën time në Portugali. Unë gjithashtu kam një kopsht të huazuar, për të cilin më pëlqen shumë të kujdesem. Por gjëja më e rëndësishme është të kaloj shumë kohë me nipërit e mbesat e mia. Kam dy vajza dhe katër nipër e mbesa. Kur erdha në Zvicër, vajzat e mia qëndruan në Portugali. Më ka munguar shumë fëmijëria e tyre, veçanërisht vajza më e vogël që nuk e pashë të rritur. Ishte shumë e vështirë. Tani kujdesem shpesh për nipërit e mbesat e mia, ata kalojnë shumë kohë me ne. Ne ndihmojmë sa herë që vajzat kanë nevojë. Të kaloj kohë me nipërit e mbesat e mia dhe t'i shikoj ata të rriten është gjëja më e mirë që ka mund të më ndodh.

Marília Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Dëftesa mjekësore: A mund të kërkojë shefi një ekzaminim?

Ka 5 javë që unë jam i sëmurë. Për çdo javë shefit tim ia kam dorëzuar nga një dëftese mjekësore, që dëshmon për paaftësinë time për punë në javën vijuese. Tani shefi im donë të më dërgoj për ekzaminim tek mjeku i besueshëm. Ai së fundi më ka parë duke shëtitur përgjatë lumit Aare, dhe me këtë rast nuk i jam dukur i sëmurë. Këtë unë e përjetoj si sulm në sferën time private. A mund ai të kërkojë nga unë, që të ekzaminohem nga një mjek që nuk e njoh?



PILULË E HIDHUR: Shefat munden të dërgojnë punonjësit e tyre për ekzaminim tek mjeku i besueshëm. (Foto: iStock)

Regula Dick: Po, edhe nëse kjo mundësi nuk është theksuar qartë në kontratën tuaj të punës apo në KKP: Punëdhënësi mund të kërkojë një ekzaminim tek mjeku i besueshëm. Edhe atëherë, nëse ai ka dyshime të arsyeshme, se a kemi të bëjmë me një paaftësi pune. Edhe pse «shëtitja në Aare», varësisht nga sëmundja, nuk domethënë se njeriu është i aftë për punë, megjithatë kjo mjafton që shefi juaj të arsyetohet dyshimin e tij. Pragu në të cilin dyshimet konsiderohen të justifikuar nuk është shumë i lartë. Nëse refuzoni të shkoni tek mjeku ekzaminues, punëdhënësi juaj mund t'ju ndalojë për kohësisht pagesën e pagave. Të paktën derisa më pas të vërtetohet paaftësia për punë. Megjithatë, punëdhënësi është i detyruar të përballojë shpenzimet dhe shpenzimet e udhëtimit për ekzaminimin e urdhëruar prej tij.

(Work, 2.6.23)

Dëftesë e ndërmjetme pune: Kur kam të drejtë për të?

Nëna ime punon qe 10 vite në firmën e njëjtë dhe dëshiron që të zhvillohet më tej profesionalisht. Papritur ka zbuluar një shpallje për vend pune, i cili do ti përshatet nevojave të saja. Për të konkurruar asaj i nevojitet një dëftesë e ndërmjetme pune ng punëdhënësi i saj aktual. A ka të drejtë për këtë?

Gilles Sciboz: Gjatë marrëdhënies së punës punonjësit gjithmonë kanë të drejtë në dëftesë të ndërmjetme të punës, nëse kemi të bëjmë me gjendje të veçantë si fjala bie ndërrimi i eprorit në punë, kërkimi i një vendi pune, apo në rast të kalimit të ndërmarrjes. Në raste të tilla punëdhënësi është i obliguar që të lëshojë një dëftesë të ndërmjetme pune, nëse kjo dëshirohet nga punonjësi. Mirëpo për të kërkuar një dëftesë të ndërmjetme pune, punonjësit kanë të drejtë kurdoherë. Kështu e parasheh ligji (neni 330 i të drejtës obligative - OR). Me këtë rast është me rëndësi të dihet, se kjo e drejtë nuk duhet të arsyetohet tek shefi.

Në rastin e nënës suaj kjo domethënë si në vijim: Ajo ka të drejtë në dëftesë të ndërmjetme pune për të kompletuar konkurrimin e saj. Mirëpo, arsye se pse asaj i nevojitet një dëftesë e tillë, ajo nuk duhet t'ia komunikoi punëdhënësit të vet.

Duhet pasur parasysh, që nuk ekziston e drejta për lëshimin e një dëftesë të ndërmjetme pune rregullisht.

(Work, 16.6.23)

Puna provuese: A lejohet të caktohet për herë të dytë?

Motra ime ka lidhur një kontratë pune tremujore me një firmë për ndërmjetësimin e punës. Tani pas kalimit të kësaj periudhe kohore ajo nga firma ku është ndërmjetësuar ka marrë një kontratë të përhershme pune. Kjo kontratë - e pa afatizuar, parasheh një punë provuese tremujore. A lejohet që firma në fjalë të përcaktojë një punë provuese, edhe pse motra ime tanimë ka punuar për tre muaj për ta?

Gilles Sciboz: Në raste të zakonshme puna provuese ka të bëjë me një marrëdhënie pune të parë mes palëve të përfshira. Nëse në mes tyre pasojnë dy kontrata pune të njëpasnjëshme apo brenda një periudhe të shkurtër, puna provuese është e pa lejueshme, me ç' rast duhet pasur parasysh, se një pushim pa pagesë përjashton detyrimet e ndërsjella kontraktuese, mirëpo nuk e përfundon kontratën. Nëse megjithatë firma në fjalë një punëtor të përkohshëm e punëson përherë, lejohet një punë e re provuese, nëse palët kontraktuese janë të ndryshme. Kjo edhe është kështu në rastin e motrës suaj: Edhe pse ajo në të njëjtën firmë i ka detyrat e njëjta, firmës i lejohet të përcaktojë një punë të re provuese, pasi që: në kontratën e re të punës tanimë ajo është e shënuar si punëdhënëse e jo firma për ndërmjetësim pune të përkohshme.

(Work, 16.6.23)

Të gjithë në demonstratën e klimës më 30 shtator – për ristrukturim eko-social!


Ndikimet shkatërruese të krizës klimatike po bëhen gjithnjë e më të dukshme. Në radhë të parë të prekur janë shumë punonjës, të cilët janë të ekspozuar ndaj rritjes së temperaturave dhe ngjarjeve të ndryshimit të jashtëzakonshëm të motit. Ajo që nevojitet tani është një ristrukturim i ekonomisë dhe shoqërisë që është njëkohësisht ekologjik dhe social, një ristrukturim eko-social: Neutraliteti CO2 dhe një shpërndarje e drejtë e mirëqenies, shanse për jetë dhe punë të mirë e të qëndrueshme për të gjithë.

Më 30 shtator 2023 nga ora 14:00, Aleanca Klimatike së bashku me njerëz dhe organizata të shumta, sindikata dhe lëvizje organizon një demonstrim klimatik në Bernë. Natyrisht, edhe Unia është aty. Eja edhe ti!

Grumbullimi për demonstratë: në ora 14, tek Bollwerk Bernë

Blloku sindikalist mbledhet tek kapitullin Bulwark.

www.klima-demo.ch



Simpoziumi i Unia

Trafikimi i qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzim pune

Trafikantët kriminelë të qenieve njerëzore e vejnë në dispozicion fuqinë e tyre duke përdorur kërcënime ose detyrime fizike dhe psikologjike. Si mund të njihen dhe parandalohen më mirë situata të tilla në një fazë të hershme? Unia nxjerr mësim nga praktika dhe i prezanton përgjigjet e saja në broshurën e saj të re, e cila paraqitet në simpozium si pjesë e javëve të veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Broshura e re e Unia, që do të prezantohet, tregon se cilat masa kanë rezultuar të suksesshme në zbulimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Në referatat e ndryshme do të the-



ksohen qëllimet dhe perspektivat aktuale (Plani i III-të Kombëtar i Veprimit 2023-2027, puna e grupit parlamentar për trafikimin e qenieve njerëzore, organizatat e specializuara të lidhura me platformën zvicerane kundër trafikimit të qenieve njerëzore, analiza e sfidave dhe instrumentet ligjore). Më pas, një tryezë e rrumbullakët do të trajtojë rolin e organizatave sindikale dhe shoqatave të punëdhënësve.

Kur: Të hënën me 23.10.2023, nga ora 16 deri 19:30

Ku: Sekretariat qendroi i Unia, Bernë

(Unia Zentralsekretariat, Bern)

(Përkthim i njëkohësisht në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht)

Pjesëmarrja është pa pagesë, Unia për merr përsipër harxhimet e udhëtimit për aktivistët e sindikatës

Më shumë informacione:
bit.ly/47EnPVd

Pensionimi i pleqërisë në Zvicër – për anëtarët shqipfolës

Në vazhden e kurseve në kuadër të institutit arsimor të Sindikatave «Movendo» ju njoftojmë se sivjet, nga data 28.10. – 29.10.2023 në Hotel Flora Alpina, Vitznau, do të mbahet kursi dyditor i radhës në gjuhën shqipe me temën «Planifikimi i pensionimit për migrantë».

Si funksionon sistemi i pensionimit në Zvicër? Si bëhet llogaritja e viteve kontributeve në Zvicër dhe në vendin e prejardhjes? Cilët hapa duhet të ndërmerren paraprakisht dhe cilat janë pasojat në rast të kthimit në vendin e prejardhjes? Pjesëmarrësit do të infor-



Hotel Floralpina

mohen edhe për vend-këshillimet dhe institutet e autorizuar, ku të interesuarit mund të drejtohen sipas nevojës.

Të interesuarit për pjesëmarrje luten të plotësojnë fletëregjistrimin dhe ta dërgojnë me postë, ta skanojnë dhe ta dërgojnë përmes E-Mail në: info@movendo.ch apo të regjistrohen për pjesëmarrje drejtpërdrejtë në faqen e internetit të www.movendo.ch

Jeni të mirëpritur nga ligjëruesi i kursit Ruzhdi Ibrahim!

MOVENDO
Das Bildungsinstitut der Gewerkschaften

Impressum: Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | **Herausgeber** Verlagsgesellschaft work AG, Zürich | **Chefredaktion** Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne | **Chefredaktion** Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano | **Chefredaktion** Gianfranco Helbling | **Redaktionskommission** O. Osmani, E. Sariaslan, D. Filipović, M. Martin, M. Mendes | **Spracheverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** I. Schmieler, Unia | **Druck** CH Media Print AG | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 16, osman.osmani@unia.ch

UNIA